



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS RAHOVEC

Numri i lëndës: 2022:126129
Datë: 19.09.2022
Numri i dokumentit: 03432297

CP.nr.129/2022

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË – DEGA NË RAHOVEC, gjyqtari **Betim Behluli**, në çështjen juridike të përmbarimit sipas propozimit për përmbarim të kreditorëve të përmbarimit G. L. dhe Q. K. nga fshati Radoste Komuna Rahovec, të cilët i përfaqëson përfaqësuesi i tyre i autorizuar Av. D. M. nga Prizreni, i paraqitur kundër debitorës së përmbarimit Komunës së Rahovecit - Drejtoria Komunale e Arsimit (DKA) në Rahovec, e për përmbarimin e dokumentit të përmbarimit – aktgjykimit të Gjykatës Themelore Gjakovë, Dega Rahovec, C.nr.485/2019, të datës 26.04.2021, i plotfuqishëm dhe ekzekutueshëm, për shkak të detyrimit në të holla në emër të pagave jubilarë në shumë të përgjithshme prej **2,387,97** Euro, duke vendosur për debitimin e mjeteve përmes xhirollogarive gjegjëse bankare, jashtë seancës gjyqësore, me dt. 20.08.2022, mori këtë:

A K T V E N D I M

I. URDHËROHET, Ministria e Financave e Republikës së Kosovës në Prishtinë – Llogaria e vetme e Thesarit, që në emër të detyrimit të përcaktuar me aktvendimin e kësaj gjykate, CP.nr.129/2022 të datës 16.08.2022, për lejimin e përmbarimit të dokumentit të përmbarimit - aktgjykimit të Gjykatës Themelore Gjakovë, Dega Rahovec, C.nr.485/2019, të datës 26.04.2021, i plotfuqishëm dhe ekzekutueshëm, për shkak të detyrimit, kreditorëve **G. L.**, shumën prej 1,184.27€, të gjitha me kamatë ligjore prej 8 %, duke llogaritur nga dita e marrjes së aktgjykimit prej datës 19.12.2019 deri me datën 08.08.2022, sipas ekspertizës të ekspertit financiar, shumën prej 121.27 €, apo shumën e përgjithshme prej **1,305.54 €**, **Q. K.** shumën prej 1,203.70 €, të gjitha me kamatë ligjore prej 8 %, duke llogaritur nga dita e marrjes së aktgjykimit prej datës 02.11.2020 deri me datën 08.08.2022, sipas ekspertizës të ekspertit financiar, shumën prej 123.26 €, apo shumën e përgjithshme prej **1,229.70**, përkatësisht për të dy kreditorët, shumën e përgjithshme prej **2,535.24 €**, si dhe shpenzimet e procedurës përmbarimore **gjithsejtë në shumë prej 335,00** Euro dhe atë për propozim shumën prej 234,00 Euro, për taksë gjyqësore shumën prej 31,00 Euro si dhe 70,00 Euro për ekspertizë financiare, në atë mënyrë që nga xhirollogaria bankare e debitorës së përmbarimit, Komuna e Rahovecit - Drejtoria Komunale e Arsimit në Rahovec, me **nr.1000650250000012**, e cila gjendet te BQK-ja me seli në Prishtinë, t'i bart këto mjetet monetare, në llogari të veçantë bankare të përfaqësuesit të autorizuar të kreditorëve av. D. M. në xhirollogarinë e tij bankare, me **nr. 1404-0000-0379-8743** pranë Bankes Ekonomike.

II. OBLIGOHET, Ministria e Financave e Republikës së Kosovës – Llogaria e vetme e Thesarit në Prishtinë, që gjykatën t'a njoftoj me shkrim për zbatimin e këtij aktvendimi ose për arsyet e mos zbatimit të tij.

A r s y e t i m

Gjykata propozimin për ekzekutim ia ka dërguar të paditurës Komunës së Rahovec, për përgjigje mirëpo e njëjta edhe pse e ka pranuar propozimin, e njëjta nuk ka ushtruar prapësim.

Meqenëse pala kreditore në propozimin e saj për përmbarrim, ka cekur mjetin gjegjës të përmbarrimit - transferimin e mjeteve monetare përmes xhirollogarive bankare e me qëllim të realizimit të detyrimit të lartë cekur në të holla dhe se pas shqyrtimit të të gjitha shkresave të lëndës, kjo gjykatë gjeti se në rastin konkret, duhet të bëhet debitimi i mjeteve të lartcekura monetare në emër të të pagave jubilarë, t'ia paguaj kreditorëve G. L., shumën prej 1,184.27€, të gjitha me kamatë ligjore prej 8 %, duke llogaritur nga dita e marrjes së aktgjykimit prej datës 19.12.2019 deri me datën 08.08.2022, sipas ekspertizës të ekspertit financiar, shumën prej 121.27 €, apo shumën e përgjithshme prej 1,305.54 €, Q. K. shumën prej 1,203.70 €, të gjitha me kamatë ligjore prej 8 %, duke llogaritur nga dita e marrjes së aktgjykimit prej datës 02.11.2020 deri me datën 08.08.2022, sipas ekspertizës të ekspertit financiar, shumën prej 123.26 €, apo shumën e përgjithshme prej 1,229.70, përkatësisht për të dy kreditorët, shumën e përgjithshme prej 2,535.24 €, si dhe në po të njëjtin afat ti paguaj edhe shpenzimet procedurale dhe atë në shumën e lartë cekur përmes bartjes së tyre përmes xhirollogarive gjegjëse bankare dhe atë për këtë arsye :

Me shikim në shkresat e lëndës, CP.nr.129/2022 të datës 16.08.2022 kjo gjykatë ka gjetur se në rastin konkret pjesë e detyrimit që rrjedh nga dokumenti i përmbarrimit – aktgjykimit të Gjykatës Themelore Gjakovë, Dega Rahovec, C.nr.485/2019, të datës 26.04.2021, i plotfuqishëm dhe ekzekutueshëm e për shkak të detyrimit në të holla, është kompensimi gjegjës në të holla i përshkruar si më lartë e përkitazi me përmbarrimin për realizimin e kredisë në të holla kundër debitorës së përmbarrimit, si në rastin konkret me debitimin e mjeteve financiare përmes xhirollogarive gjegjëse bankare, bëhet fjalë në nenin 152 të LPP-së e në rastin konkret, duke u bazuar në dokumentin e lartë cekur përmbarrimit, se debitorja e përmbarrimit, Komuna e Rahovecit - Drejtoria Komunale e Arsimit në Rahovec, është e obliguar që kreditorëve të përmbarrimit, G. L., shumën prej 1,184.27€, të gjitha me kamatë ligjore prej 8 %, duke llogaritur nga dita e marrjes së aktgjykimit prej datës 19.12.2019 deri me datën 08.08.2022, sipas ekspertizës të ekspertit financiar, shumën prej 121.27 €, apo shumën e përgjithshme prej 1,305.54 €, Q. K. shumën prej 1,203.70 €, të gjitha me kamatë ligjore prej 8 %, duke llogaritur nga dita e marrjes së aktgjykimit prej datës 02.11.2020 deri me datën 08.08.2022, sipas ekspertizës të ekspertit financiar, shumën prej 123.26 €, apo shumën e përgjithshme prej 1,229.70, përkatësisht për të dy kreditorët, shumën e përgjithshme prej 2,535.24 €, të llogaritur në bazë të ekspertizës së ekspertit M. D. prej datës 08.08.2022, si dhe shpenzimet procedurale dhe atë në shumën e lartë cekur, andaj me arsyet e cekura më lartë kjo gjykatë, vendosi që të urdhëroj Ministrinë e Financave me seli në Prishtinë - Llogarinë e Thesarit, që të bëjë debitimin e mjeteve monetare në shumën e lartcekur e më gjerësisht me përshkrimin e bërë si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Prandaj, nga ajo që u tha më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi e në kuptim të nenit 3, 5 par.6 pika 2, 109 par.3, 113 dhe nenin 152 të LPP-së.

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË – DEGA NË RAHOVEC
CP.nr.129/2022, më 19.09.2022

G j y q t a r i
Betim Behluli

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi nuk lejohet ankesë e veçantë.